

LIGJ
Nr. 125/2013

PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT¹

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:
KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është të krijojë një kuadër të favorshëm dhe të qëndrueshëm për nxitjen, thithjen dhe krijimin e lehtësive për investimet që realizohen si koncesione/partneritete publike private.

Neni 2
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktuese për të hyrë në marrëveshje koncesionesh/partneritetesh publike private, për investime të bazuara në koncesione/partneritete publike private, procedurat për dhënien e kontratave të tilla, si nënshkrimi, ndërprerja dhe ndryshimet e marrëveshjeve të koncesionit/partneritetit publik privat, çështjet që kanë të bëjnë me rregullimet financiare dhe mbështetjen, në lidhje me koncesionet/partneritetet publike private, politikën e këtyre koncesioneve e autoritetin për zbatimin e tyre, si dhe çështje të tjera që lidhen me koncesionet/partneritetet publike private.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Koncesion” është koncesioni i punëve publike ose koncesioni i shërbimeve publike.
2. “Koncesioni i punëve publike” është një marrëveshje me interes financiar, e lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, objekti i së cilës është kryerja e punimeve, ku shpërblimi për punimet që duhet të kryhen përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar veprat që janë objekt i kontratës ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën.
3. “Koncesioni i shërbimeve publike” është një marrëveshje me interes financiar në formë të shkruar ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, objekti i së cilës është sigurimi i shërbimeve, ku shpërblimi për shërbimet që do të sigurohen përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar shërbimet që janë objekt i kontratës ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën.
4. “Koncesion i përzier” është një koncesion, objekti i të cilit është kryerja e punimeve dhe

¹ Ky ligj përafron direktivën 2004/18/EC të Parlamentit European dhe të Këshillit të 31 marsit 2004 për koordinimin e procedurave të prokurimit për shpalljen fituese të kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime, numri CELEX: 32004L0018, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr. 134, datë 30.4.2004, faqe 114-240.

sigurimi i shërbimeve, që identifikohet si koncesion i punëve publike ose koncesion i shërbimit publik dhe ku vendimtar për të përcaktuar nëse një kontratë e tillë është koncesion i punëve publike apo një koncesion i shërbimeve publike është elementi nëse puna që do të kryhet është objekti kryesor i kontratës apo nëse puna është thjesht karakteristike për shërbimin publik që është objekt i kontratës.

5. “E drejta për të shfrytëzuar veprat dhe/ose shërbimet” ka kuptimin e mëposhtëm:

a) e drejta për të nxjerrë të ardhura, në përputhje me kontratën e koncesionit; si dhe

b) transferimi të koncesionari i një pjese të konsiderueshme të riskut operacional, që lidhet me objektin e një koncesioni të punëve publike ose të shërbimeve publike. Do të quhet se koncesionari ka marrë një pjesë të konsiderueshme të riskut operacional, në qoftë se mbështetja financiare e dhënë direkt ose indirekt nuk garanton se do të realizojë kthimin e investimit apo mbulimin e kostove që rezultojnë nga menaxhimi i punëve dhe/ose i shërbimeve, të cilat janë objekt i koncesionit. Risku operacional ka kuptimin e riskut, që lidhet me përdorimin e veprave ose ofrimit të shërbimeve ose riskun që lidhet me disponueshmërinë e objektit të infrastrukturës që ndërtohet ose përdoret për të siguruar shërbime për përfituesit fundorë, në përputhje me kontratën e koncesionit.

6. “Komunikimi me shkrim” është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, të kopjohen dhe të komunikohen, përfshirë dhe informacionin që transmetohet dhe ruhet me mjete elektronike.

7. “Realizimi i punëve” është projektimi dhe realizimi me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me objektin e koncesionit dhe me kërkesat e specifikuar nga autoriteti kontraktues.

8. “Punë” është objekti, i cili është rezultati i ndërtimit ose i veprave civile inxhinierike, të marra si një tërësi, e cila është e mjaftueshme në vetvete për të përmbushur një funksion ekonomik ose teknik.

9. “Sigurimi i shërbimeve” është sigurimi apo realizimi i shërbimit publik që korrespondon me objektin e koncesionit dhe me kërkesat e specifikuar nga autoriteti kontraktues.

10. “Objekti i koncesionit” janë veprat publike dhe/ose shërbimet publike të siguruar në bazë të një marrëveshjeje koncesioni në çdonjërin nga sektorët e ligjshëm të renditur në këtë ligj.

11. “Koncesionari” është operatori ekonomik ose subjekti për qëllime të veçanta, me të cilin autoriteti kontraktues ka nënshkruar një kontratë koncesioni.

12. “Subjekti për qëllime të veçanta (SPV)” është një person juridik privat, me seli në Republikën e Shqipërisë, i krijuar me kërkesë të autoritetit kontraktues nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofruesi më i suksesshëm, me të cilin lidhet kontrata.

13. “Projekte” janë një sërë aktivitete të ndërlidhura, që ndërmerren në një mënyrë të caktuar, me qëllimin e arritjes së objektivave të qartë brenda një periudhe kohore të specifikuar dhe brenda një kuadri të caktuar financiar.

14. “Objekti” është rezultati i ndërtimit ose i një infrastrukture ekzistuese publike në posedim, që përdoret ose zotërohet nga koncesionari/partneri privat ose një infrastrukturë publike që do të realizohet në zbatim të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat dhe që mund të sigurohet për të mirën e publikut ose të ndonjë pjese të publikut.

15. “Propozim i pakërkuar” është propozimi për të marrë përsipër projekte koncesioni, i cili nuk ka ardhur në përgjigje të një kërkesë të bërë nga autoriteti kontraktues, në kuadër të një procedure përzgjedhëse konkurruese.

16. “Mbështetja financiare” është lloji i mbështetjes monetare ose jomonetare dhe/ose financimi i dhënë nga sektori publik, duke përfshirë, por pa u kufizuar, subvencione, garanci financiare apo të tjera, kontribute kapitale dhe transferim të të drejtave të pronësisë.

17. “Vlera e parasë” është një term, i cili përdoret për të përcaktuar nëse autoriteti kontraktues ka marrë fitimet maksimale të mundshme nga punët apo shërbimet e dhëna me koncesion/partneritet publik privat. Ky term nuk kufizohet në masën e vlerës së parasë së punëve/shërbimeve, por përfshin, gjithashtu, edhe vlerësimin e cilësisë, kostos dhe shfrytëzimin e burimeve, përshtatshmërinë me qëllimin dhe objektivin e kontratës, kohën dhe mundësinë për të vendosur nëse të gjitha këto elemente të kombinuara përbëjnë vlerën me të mirë ekonomike.

18. “Kontraktues” është çdo person, fizik ose juridik, ent publik ose grup personash dhe/ose organesh të tilla që ofrojnë në treg, respektivisht, realizimin e punëve dhe/ose të punëve dhe shërbimeve.

19. “Operator ekonomik” është kontraktuesi, sipërmarrësi i punëve ose shërbimeve.

20. “Procedura e shpalljes së fituesit” është procedura e hapur, e kufizuar ose e negociuar, e rregulluar me ligjin e prokurimit publik, që realizohet nga autoriteti kontraktues, në mënyrë që të japë një koncesion/partneritet publik privat.

21. “Dokumentet e tenderit” janë dokumentet që autoriteti kontraktues ua vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm si një bazë për përgatitjen e ofertave të tyre.

22. “Kontratë koncesioni” është një kontratë e nënshkruar ndërmjet autoritetit kontraktues në njërën anë dhe operatorit ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm apo subjektit, për qëllime të veçanta (SPV), i themeluar nga operatori ekonomik në fjalë, kontratë e cila përmban përcaktimet që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet në lidhje me koncesionin e dhënë.

23. “Kontratë e partneritetit publik privat” ka kuptimin e një kontrate pune publike apo kontrate të shërbimit publik, që plotëson kushtet, të cilat e përcaktojnë atë si një partneritet publik privat, sikurse është rregulluar në këtë ligj dhe që nënshkruhet ndërmjet autoritetit kontraktues në njërën anë dhe operatori ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm.

24. “Nënshkruesi i autorizuar” është një person i autorizuar nga autoriteti kontraktues për të nënshkruar një kontratë koncesioni/partneriteti publik privat.

Përveçse kur rregullohet ndryshe nga ky ligj, kuptimi i termave të përcaktuar në ligjin e prokurimit publik zbatohet për këtë ligj në përputhje me rrethanat.

Neni 4

Fusha e zbatimit të koncesioneve/partneriteteve publike private

1. Koncesionet/partneritetet publike private mund të jepen për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve për sektorët dhe qëllimet e mëposhtme:

a) transport (sistemin e hekurudhave, transportin hekurudhor, portet, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, parkimin, transportin publik);

b) prodhim dhe shpërndarje e energjisë elektrike dhe energjisë për ngrohje;

c) prodhim dhe shpërndarje e ujit, trajtim, mbledhje, shpërndarje dhe menaxhim i ujërave të zeza, ujitje, drenazhim, pastrim i kanaleve dhe digave;

ç) menaxhim i mbeturinave, duke përfshirë mbledhjen, trajtimin, transferimin dhe depozitimin e tyre;

d) telekomunikacion;

dh) shkencë dhe arsim;

e) turizëm, argëtim dhe hoteleri;

ë) kulturë dhe sport;

f) shëndetësi;

g) shërbime sociale;

gj) burgje dhe infrastrukturë gjyqësore;

h) rehabilitim i tokës dhe pyjeve;

i) parqe industriale, miniera dhe infrastrukturë të ngjashme për mbështetjen e biznesit;

j) strehim;

k) godina të administratës publike, teknologji e informacionit dhe infrastrukturë e bazës së të dhënave;

l) shpërndarje e gazit natyror;

ll) rehabilitim dhe zhvillim urban dhe suburban.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrive të linjës apo propozime që këto i marrin nga autoritete të njësisë të qeverisjes vendore apo të organeve qendrore të politikës së koncesioneve/partneriteteve publike private, vendos për koncesionet/partneritetet publike private që zbatohen në sektorë të tjerë.

3. Në raste të veçanta, Këshilli i Ministrave mund të ofrojë koncesione për operatorët ekonomikë, vendas apo ndërkombëtarë, me çmimin simbolik 1 euro.

Neni 5 **Përrjashtimet**

1. Ky ligj nuk zbatohet për koncesionet/partneritetet publike private, në rastet e mëposhtme:

- a) nën kufirin e ulët monetar;
 - b) kur realizimi i tyre duhet të shoqërohet me masa të veçanta të sigurisë, në përputhje me ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative në fuqi apo kur një gjë e tillë kërkohet nga mbrojtja e interesave thelbësorë të shtetit;
 - c) për blerjen ose marrjen me qira, me çfarëdo mjetesh financiare, të pasurisë së paluajtshme ose të të drejtave të lidhura me to. Megjithatë, kontratat e shërbimeve financiare, të nënshkruara në të njëjtën kohë para ose pas kontratës së blerjes ose të qirasë, në çfarëdo forme, i nënshtrohen këtij ligji;
 - ç) për blerjen, zhvillimin, prodhimin ose bashkëprodhimin e materialeve të programit apo reklamave të destinuara për transmetim nga transmetuesit ose për publikimin në media dhe kontratat për kohën e transmetimit;
 - d) për koncesionet, të cilat u nënshtrohen rregullave të ndryshme dhe që jepen në përputhje me rregullat procedurale të veçanta të organizatave ndërkombëtare;
 - dh) për shërbimet e arbitrazhit dhe të pajtimit;
 - e) për shërbimet financiare, në lidhje me nxjerrjen, shitjen, blerjen, apo transferimin e titujve ose instrumenteve të tjera financiare, në mënyrë të veçantë, transaksionet nga autoritetet kontraktuese për të mbledhur para ose kapital;
 - ë) për të gjitha shërbimet e përmendura në procedurat për dhënien e kontratave sektoriale në ligjin e prokurimit publik;
 - f) për shërbimet e transportit ajror;
 - g) për koncesione/partneritete publike private që u nënshtrohen rregullave të ndryshme dhe që janë dhënë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat Republika e Shqipërisë i ka lidhur me një ose disa shtete të tjera, të nënshkruara në pajtim me Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe që përfshijnë punë, mallra apo shërbime të destinuara për zbatimin e përbashkët ose përdorimin e projekteve nga ana e vendeve nënshkruese;
 - gj) për koncesionin/partneritetin publik privat, në atë masë që ky ligj bie ndesh me një detyrim të shtetit, që është në bazë ose që rrjedh prej një marrëveshjeje me një ose më shumë shtete të tjera a me një organizëm ndërkombëtar, mbizotërojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje. Në të gjitha aspektet e tjera, procedurat dhe parimet e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat rregullohen me këtë ligj;
 - h) për koncesionet e shërbimit publik që një autoritet kontraktues ia ka dhënë një autoriteti tjetër kontraktues ose një shoqatë të autoriteteve kontraktuese, në bazë të një të drejte ekskluzive që ata gëzojnë, sipas legjislacionit në fuqi;
 - i) për koncesionet e punëve publike që jepen për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e hidrocentraleve për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.
2. Rastet e përjashtuara, sipas pikës 1 të këtij neni, rregullohen me dispozita të tjera ligjore ose nënligjore.

Neni 6 **Licencat dhe lejet**

Ky ligj nuk zbatohet për licencat dhe lejet administrative që u jepen operatorëve ekonomikë, autoriteteve kontraktuese, enteve kontraktuese dhe organeve të tjera të sektorit privat apo publik.

Neni 7 **Koncesionet për hidrocentralet**

1. Projektet për dhënien me koncesion të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike mund

të realizohen në bazë të një propozimi të pakërkuar, ku propozuesit të propozimit të pakërkuar mund t'i jepet një bonus deri në maksimumin prej 10 për qind të pikëve për pikëzimin e llogarit, në përputhje me kriteret e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në njoftimin e kontratës për dhënien e një kontrate të tillë.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për mënyrën e identifikimit, vlerësimit dhe realizimit të projekteve të përshkruara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 8

Partneriteti publik privat

1. Partneriteti publik privat nënkupton një formë bashkëpunimi afatgjatë, të rregulluar me kontratë, ndërmjet autoritetit kontraktues, domethënë partnerit publik, dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, domethënë partnerit privat, ku:

a) partneri privat merr përsipër detyrimin për t'u ofruar shërbime publike përdoruesve të shërbimeve brenda fushës së kompetencave të partnerit publik dhe/ose detyrimin për t'i siguruar partnerit publik parakushtet e nevojshme për t'u ofruar shërbimet publike përdoruesve të shërbimeve dhe/ose veprimtaritë brenda fushës së kompetencave të tij;

b) partneri privat, me qëllim që të përmbushë detyrimet e shkronjës “a” të kësaj pike, mund të marrë përsipër:

i) detyrimin që të financojë, të projektojë, të ndërtojë dhe/ose të rindërtojë/të rinovojë objektin e infrastrukturës publike, të operojë dhe të mirëmbajë objektin e infrastrukturës publike të ndërtuar dhe /ose të rindërtuar/të rinovuar rishtazi;

ii) detyrimin që të përdorë, të operojë dhe të mirëmbajë një objekt ekzistues të infrastrukturës publike;

iii) çdo kombinim i detyrimeve të përmendura më lart, për sa kohë që kombinimi i këtyre detyrimeve është për qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) në kuadër të marrjes përsipër të detyrimeve të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, partneri privat zakonisht merr përsipër nivele dhe shtrirje të ndryshme të risqeve, që lidhen me financimin, ndërtimin, kërkesën dhe/ose disponueshmërinë, dhe të tjera si operimi, menaxhimi, mirëmbajtja dhe risqet teknike, varësisht nga forma e partneritetit publik privat dhe varësisht nga përcaktimi, rast pas rasti;

ç) për kohëzgjatjen e partneritetit publik privat çdo partner zakonisht merr përgjegjësinë për rastet e riskut që janë nën sferën e ndikimit të tij ose përgjegjësia ndahet;

d) partneri privat shpërblehet kryesisht, por jo ekskluzivisht, dhe në përputhje me kontratën:

i) duke iu dhënë e drejta për të shfrytëzuar veprat publike dhe/ose shërbimin publik, kryesisht me qëllimin e vendosjes së tarifave ose pagesave nga përdoruesit fundorë dhe konsumatorët ose kjo e drejtë së bashku me mbështetjen financiare;

ii) me pagesat e rregullta të drejtpërdrejta të paguara nga ose në emër të partnerit publik, zakonisht në lidhje me disponueshmërinë e objektit dhe/ose shërbimit të ofruar;

iii) me forma të tjera të mbështetjes financiare, duke përfshirë transferimin e të drejtave materiale dhe të drejtave të tjera reale;

iv) një kombinim i mjeteve të përshkruara më lart;

dh) partneri publik i mundëson partnerit privat kryerjen e aktiviteteve tregtare, të përcaktuara në kontratë së bashku me detyrimet që rrjedhin nga shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, nëse kjo siguron nivelin e nevojshëm të efikasitetit të kostos së pjesëmarrjes private dhe kthimit të arsyeshëm të investimit, si dhe një vlerë më të mirë të parasë.

2. Përveç kërkesave të përcaktuara në këtë nen, partneriteti publik privat mund të përfshijë krijimin e një subjekti për qëllime të veçanta (SPV) me kapital të përzier, që zotërohet bashkërisht nga partneri publik dhe privat. Nëse kontributet kapitale të partnerit publik janë të tilla që vlera ose ndikimi i tyre eliminojnë transferimin e nevojshëm të risqeve kryesore të natyrshme të projektit te partneri privat, siç rregullohet nga ky ligj, një kontratë apo ndërmarrje e tillë nuk konsiderohet si një partneritet publik

privat (PPP).

3. Kontratat e prokurimit publik, që nuk i plotësojnë kushtet e këtij neni, nuk konsiderohen partneritet publik privat. Kushte të tilla nënkuptojnë, por nuk kufizohen vetëm në kohëzgjatjen e kontratës, transferimin e risqeve kryesore të natyrshme dhe mjetet e shpërblimit.

4. Varësisht nga mjetet e shpërblimit, si dhe ndarja e risqeve kryesore të natyrshme, një partneritet publik privat mund të realizohet në një nga format e mëposhtme:

- a) si punë publike me koncesion;
- b) koncesion i shërbimeve publike;
- c) kontratë e punëve publike;
- ç) kontratë e shërbimit publik.

5. Këshilli i Ministrave miraton një dokument strategjik politikash për përcaktimin e sektorëve parësorë për investime të bazuara te partneriteti publik privat, të formave të preferuara të partneritetit publik privat dhe çështje të tjera që lidhen me kuadrin e përgjithshëm të politikave për koncesionet dhe partneritetet publike private në Republikën e Shqipërisë.

Neni 9

Parimet themelore

Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private zbatohet në përputhje me parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit, trajtimit të barabartë, reciprocitetit dhe të sigurisë ligjore.

Neni 10

Ministria e Financave

1. Autoriteti i Ministrisë të Financave, lidhur me koncesionet/partneritetin publik privat, ushtrohet sipas përcaktimeve në nenet e veçanta të këtij ligji.

2. Kur tarifa koncesionare nuk paguhet në përputhje me përcaktimet e nenit 29 të këtij ligji, autoriteti kontraktues njofton Ministrinë e Financave, urdhri i të cilit për arkëtimin e tarifës përbën titull ekzekutiv për bankat e nivelit të dytë ku ndodhet llogaria bankare e shoqërisë koncesionare, që vihet në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor.

3. Të gjitha autoritetet kontraktuese, brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti, dërgojnë në Ministrinë e Financave pasqyrat financiare vjetore të vitit paraardhës të shoqërive koncesionare, të cilat hidhen në regjistrin kombëtar.

Neni 11

Agjencia e Prokurimit Publik

Agjencia e Prokurimit Publik është autoriteti kompetent për koncesionet dhe partneritetin publik privat dhe në këtë drejtim ajo kryen detyrat e mëposhtme:

a) zbatimin e masave dhe aktiviteteve në mënyrë që të arrijë dhe të ruajë një sistem plotësisht transparent dhe efikas të koncesioneve/partneriteteve publike private, përfshirë këtu edhe monitorimin e procedurave të koncesionit pas lidhjes së kontratës;

b) përgatitjen e projekt-propozimeve për ndryshimin e legjislacionit në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, si dhe udhëzimeve për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;

c) në rast shkeljesh të këtij ligji dhe akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, vendosjen e gjobave ose propozimin e marrjes së masave administrative;

ç) përjashtimin e një operatori ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e koncesioneve/partneritetit publik privat, sipas përcaktimeve në ligjin e prokurimit;

d) monitorimin, analizën dhe studimin e tendencave aktuale europiane dhe globale, njohurive dhe përvojës në fushën e koncesioneve/ partneriteteve publike private;

dh) realizimin e masave dhe aktiviteteve të tjera të nevojshme për përmbushjen e detyrave që dalin nga shkronja “a” e kësaj pike;

e) hartimin dhe publikimin e dokumenteve standarde të tenderit.

Neni 12

Njësia e trajtimit të koncesioneve dhe partneriteteve publike private

Njësia e trajtimit të koncesioneve/partneriteteve publike private është në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, për të nxitur dhe asistuar autoritetet kontraktuese në përgatitjen, vlerësimin dhe negocimin e koncesioneve/partneriteteve publike private.

Neni 13

Autoritetet kontraktuese

1. Autoritetet kontraktuese janë organet, të cilave ky ligj u jep kompetencat për të ndërmarrë një procedurë për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private.

2. Autoritetet kontraktuese janë:

a) Kryeministria, ministritë e linjës;

b) Kuvendi;

c) Njësitë e qeverisjes vendore.

Neni 14

Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat

1. Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat është një bazë të dhënash elektronike e të gjitha kontratave të koncesionit dhe të partneritetit publik privat, të dhëna në Republikën e Shqipërisë.

2. Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat krijohet dhe mbahet nga Ministria e Financave, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për përmbajtjen dhe formën e regjistrit të koncesioneve/partneritetit publik privat.

Neni 15

Konfidencialiteti

Dispozitat e ligjit të prokurimit publik, që rregullojnë konfidencialitetin, zbatohen edhe për koncesionet/partneritetet publike private të rregulluara me këtë ligj.

KREU II

VEPRIMET PËRGATITORE PËR DHËNIEN E KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

Neni 16

Veprimet përgatitore për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat

1. Veprime përgatitore për dhënien e një koncesioni/partneriteti publik privat quhen të gjitha aktivitetet e kryera me qëllimin e dhënies së kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat dhe të cilat i paraprijnë procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat.

2. Veprimet përgatitore zbatohen nga autoriteti kontraktues, në përputhje me këtë ligj, me ligjin për prokurimin publik dhe legjislacionin në fuqi, në varësi të objektit të koncesionit/partneritetit publik privat.

3. Veprimet përgatitore nënkuptojnë, në mënyrë të veçantë, sa më poshtë:

- a) identifikimin e projekteve të mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat;
- b) emërimin e një komisioni për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat;
- c) përgatitjen e studimit të fizibilitetit të një koncesioni/partneriteti publik privat;
- ç) përllogaritjen e vlerës së kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat;
- d) përgatitjen e dokumenteve të tenderit.

4. Autoriteti kontraktues mund të angazhojë njësinë e trajtimit të koncesioneve dhe, nëse është nevoja, këshilltarë/konsulentë të jashtëm për të siguruar mbështetjen e ekspertëve në përgatitjen, dhënien dhe zbatimin e projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat.

5. Këshilli i Ministrave miraton rregulla më të hollësishme në zbatim të pikës 3 të këtij neni.

Neni 17

Identifikimi i projekteve të mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat

1. Autoriteti kontraktues identifikon dhe shqyrton projektet e mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat brenda sferës së kompetencave të tij.

2. Autoriteti kontraktues informohet dhe mund të marrë në shqyrtim projektet e mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat të identifikuar apo të propozuara nga:

- a) Kryeministria;
- b) autoritetet e tjera kontraktuese të së njëjtës hierarki administrative, organet e qeverisjes qendrore apo vendore;
- c) institucionet dhe organizatat vendase dhe ndërkombëtare financiare dhe të zhvillimit;
- ç) institucionet dhe organizatat shkencore vendase dhe ndërkombëtare;
- d) operatorët ekonomikë nëpërmjet propozimeve të pakërkuar.

3. Vetëm ato projekt-propozime, të cilat janë konsideruar si të pranueshme nga procedurat e ndërmarra, në përputhje me nenin 16 të këtij ligji, u nënshtrohen veprimeve të mëtejshme përgatitore siç rregullohet nga ky ligj.

4. Autoriteti kontraktues njofton Agjencinë e Prokurimit Publik çdo gjashtë muaj për projektet e koncesioneve/partneritetit publik privat në shqyrtim.

Neni 18

Komisioni i dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat

1. Para fillimit të procedurës për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat, autoriteti kontraktues cakton komisionin e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat.

2. Për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat, autoriteti kontraktues emëron anëtarët e komisionit me profesion jurist, ekonomist, profesion teknik dhe profesione nga fusha të tjera përkatëse, në varësi të objektit dhe karakteristikave të koncesionit/partneritetit publik privat.

3. Numri i anëtarëve në komisionin e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është tek, por nuk mund të kalojë 7 anëtarë.

4. Anëtarët e komisionit për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat nuk duhet të kenë interesa të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë personale në asnjë prej aktiviteteve që përbën konflikt interesi, në përmbushje të detyrave të tyre si anëtarë të komisionit për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat, gjë të cilën ata do ta konfirmojnë me nënshkrimin e një deklarate që garanton se ata nuk

kanë konflikt interesi.

5. Autoriteti kontraktues mund të emërojë një komision të vetëm të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat për më shumë se një procedurë të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat për aq kohë sa objektet e kontratave janë të ngjashme në natyrë.

6. Komisioni i dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat kryen detyrat e mëposhtme:

- a) harton studimin e fizibilitetit për koncesionin/partneritetin publik privat, përcakton procedurën e zbatueshme për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat dhe harton dokumentacionin e tenderit;
- b) shqyrton dhe vlerëson ofertat e pranuar dhe/ose kërkesat për pjesëmarrje që janë dorëzuar;
- c) formulon propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme ose propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së prokurimit, si dhe një shpjegim të tyre;
- ç) kryen të gjitha aktivitetet e tjera që kërkojnë për zbatimin e procedurës së koncesionit/partneritetit publik privat, në përputhje me rregulloret në fuqi.

7. Komisioni i dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat mban procesverbale për pasqyrimin e punës së tij, të cilat duhet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Neni 19

Studimi i fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat

1. Studimi i fizibilitetit për koncesionin/partneritetin publik privat hartohet nga autoriteti kontraktues.

2. Studimi i fizibilitetit përmban, në mënyrë të veçantë:

- a) përmbledhjen operacionale dhe përshkrimin e përgjithshëm të projektit;
- b) analizat teknike, financiare, ekonomike dhe ligjore;
- c) studimet mjedisore dhe implikimet në natyrë;
- ç) anekset shoqëruese, shtesat e kërkuara, konkluzionet dhe rekomandimet.

3. Në studimin e fizibilitetit merren parasysh në veçanti interesi publik, ndikimi në mjedis dhe mbrojtja e mjedisit, qëndrueshmëria, përshtatshmëria financiare e projektit, treguesit e vlerës së parasë, harmonizimi i projektit me objektivat kombëtarë dhe sektorialë strategjikë, risqet direkte dhe indirekte financiare dhe ndikimet në buxhetin qendror dhe në atë të qeverisjes vendore, mbështetja e nevojshme financiare, realizueshmëria teknike dhe tregtare, si dhe interesi i tregut dhe aftësia për të tërhequr operatorët e interesuar ekonomikë dhe mbështetësit financiarë.

4. Në rastin e një koncesioni, vlera e të cilit është më pak se 300 000 000 lekë, pa TVSH, autoriteti kontraktues mund të përgatisë, në vend të studimit të fizibilitetit të koncesionit, një analizë të përmbledhur për dhënien me koncesion, ku ai është i detyruar të aplikojë vetëm parimet themelore që rregullojnë përgatitjen e studimit të fizibilitetit, në përputhje me këtë nen.

5. Studimi i fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat apo analiza e përmbledhur e dhënies me koncesion përmban:

- a) përcaktimin e llojit dhe objektin e koncesionit/partneritetit publik privat;
- b) vlerësimin e risqeve të drejtpërdrejta financiare dhe ndikimin në buxhetin e qeverisë qendrore dhe vendore;
- c) vlerën e parashikuar të kontratës;
- ç) vlerësimet në lidhje me kriteret e zgjedhjes dhe të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat;
- d) kohëzgjatjen e propozuar të kontratës, si edhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për përgatitjen e dokumentacionit të tenderit.

Neni 20

Llogaritja e vlerës së koncesionit/partneritetit publik privat

1. Autoriteti kontraktues llogarit vlerën e parashikuar të koncesionit/partneritetit publik privat si vlerë totale e objektit të koncesionit/partneritetit publik privat, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e

mundshme dhe opsionet e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, pa vlerën e TVSH-së.

2. Vlera e parashikuar e koncesionit llogaritet në bazë të të dhënave që përmban studimi i fizibilitetit përkatës ose analiza e përmbledhur e dhënies së koncesionit.

3. Vlera e parashikuar e partneritetit publik privat llogaritet sipas përcaktimeve në legjislacionin e prokurimit publik.

Neni 21

Dokumentet e tenderit

1. Dokumentet e tenderit hartohen dhe trajtohen nga autoriteti kontraktues, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

2. Pa cenuar pikën 1 të këtij neni, në dokumentet e tenderit për procedurën për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat mund të përfshihet informacion shtesë, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.

KREU III

PROCEDURA PËR DHËNIEN E KONCESIONEVE/PARTNERITETEVE PUBLIKE PRIVATE

Neni 22

Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private

1. Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private fillon me publikimin e njoftimit të kontratës dhe përfundon me publikimin e njoftimit të fituesit për dhënien e kontratës ose me vendimin për ndërprerjen e procedurës së dhënies së kontratës.

2. Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

3. Në dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private, autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurën e hapur, procedurën e kufizuar ose procedurën me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

4. Pavarësisht nga dispozitat e pikës 2 të këtij neni, kur jepen koncesione të punëve publike, afati për dorëzimin e ofertave është jo më pak se 52 ditë nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës,

Neni 23

Kriteret për dhënien e kontratës së koncesionit

1. Pavarësisht nga përcaktimi i nenit 19 të këtij ligji, kriteret mbi të cilat autoriteti kontraktues bazon zgjedhjen e ofertuesit më të suksesshëm, janë si më poshtë:

a) kur është shpallur fituese oferta ekonomikisht më e favorshme nga pikëpamja e autoritetit kontraktues, kriteret të ndryshme, lidhur me objektin e koncesionit në fjalë si, për shembull, cilësia, e cila përfshin merita teknike, karakteristikat estetike, funksionale dhe të mjedisit, kostot e drejtimit, kosto të efektivitetit, ofrimin e shërbimeve pas dorëzimit të produkteve dhe asistencën teknike, datën e dorëzimit dhe periudhën e dërgesës ose periudhën e përfundimit të punimeve, çmimin e shërbimit për përfituesit fundorë, shumën e tarifës së koncesionit;

b) tarifa koncesionare më e lartë që është ofruar.

2. Kur ofertuesi më i suksesshëm zgjidhet në bazë të kriterit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, dhënësi i koncesionit specifikon në dokumentet e tenderit dhe në njoftimin e kontratës koeficientët relativë, që ai i jep secilit prej kriterëve të zgjedhura për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme. Këta koeficientë mund të shprehen duke parashikuar një gamë me një shtrirje të përshtatshme maksimale. Kur kjo nuk është e mundur, për shkak të arsyeve të justifikuara, autoriteti

kontraktues tregon në njoftimin e kontratës kriteret sipas rendit zbritës të rëndësisë.

3. Kur ofertuesi i suksesshëm zgjidhet në bazë të tarifës më të lartë të ofruar të koncesionit, autoriteti kontraktues bën një referencë në dokumentet e tenderit dhe në kontratë të mënyrës së shprehjes së tarifës së koncesionit të ofruar në tendera, ku shuma e tarifës së ofruar të koncesionit duhet të shprehet në lekë, si njësi e tarifës së ofruar koncesionare fikse dhe/ose e ndryshueshme gjatë kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit, e zbritur nga vlera aktuale neto përkatëse në dokumentet e tenderit.

4. Nëse ndonjë akt tjetër ligjor që rregullon koncesionet përcakton tarifën më të ulët të koncesionit, të cilën koncesionari është i detyruar ta paguajë, atëherë autoriteti kontraktues e deklaron këtë shumë në dokumentet e tenderit, si shuma të cilën ofertuesit duhet ta përfshijnë në ofertat e tyre.

5. Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit.

Neni 24

Njoftimi i kontratës së koncesionit

1. Autoriteti kontraktues bën të njohur qëllimin e tij për të dhënë një koncesion me anë të një njoftimi.

2. Në njoftimin e kontratës së koncesionit duhet të përfshihen të paktën të dhënat e mëposhtme:

a) emri, adresa, numri i telefonit, numri i faksit dhe adresa e postës elektronike të autoritetit kontraktues;

b) lloji, subjekti dhe objekti i koncesionit;

c) vendndodhja e veprimtarisë koncesionare që do të ndërmerret;

ç) kohëzgjatja e kontratës së koncesionit;

d) vlera e parashikuar e kontratës koncesionare;

dh) afati i fundit për dorëzimin e ofertave;

e) adresa në të cilën duhet të dërgohen ofertat;

ë) gjuha/gjuhët dhe shkrimi/shkrimet, në të cilën/cilat duhet të hartohen ofertat;

f) koha dhe vendi i hapjes publike të ofertave;

g) kriteret për përjashtimin e ofertuesve;

gj) kriteret në lidhje me gjendjen ligjore dhe përshtatshmërinë për të ndjekur aktivitetin profesional, aftësinë teknike dhe profesionale, si dhe dëshmitë e të dhënat, me anë të të cilave një operator ekonomik vërteton plotësimin e kërkesave të tilla;

h) lloji dhe vlera e garancisë së tenderit që ofertuesit duhet të paraqesin;

i) kriteret për dhënien e kontratës;

j) emri dhe adresa e organit përgjegjës për procedurën e shqyrtimit, si dhe të dhënat për afatet për shqyrtimin e kërkesës.

3. Kur ndryshimet ose korrigjimet e njoftimit të kontratës kërkohen brenda afatit për dorëzimin e ofertave, ai ndryshohet ose korrigjohet dhe afati i fundit për dorëzimin e ofertave shtyhet, në përputhje me rrethanat, por jo më pak se 20 ditë.

4. Njoftimi i kontratës botohet në një formular standard.

5. Përmbajtja e formularit standard përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Njoftimi i kontratës publikohet në formë elektronike në platformën elektronike të prokurimit dhe në Buletinin e Prokurimit Publik.

7. Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji për prokurimin publik, në përputhje me rrethanat.

Neni 25

Propozimet e pakërkuara

1. Autoriteti kontraktues autorizohet të shqyrtojë dhe të pranojë propozimet e pakërkuara, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë nen, me kusht që këto propozime të mos kenë të bëjnë me një projekt, për të cilin procedurat e përzgjedhjes kanë nisur apo janë shpallur.

2. Nëse propozimi i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm, atëherë autoriteti kontraktues mund të ndërmarrë veprimet e duhura përgatitore për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat.

3. Propozuesi i propozimit të pakërkuar mund të marrë pjesë në procedurën e koncesionit/partneritetit publik privat me të njëjtat kushte si të gjithë operatorët e tjerë ekonomikë dhe nuk i jepet asnjë trajtim preferencial.

4. Nëse një procedurë e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat, e nisur mbi një propozim të pakërkuar, rezulton me nënshkrimin e kontratës, autoriteti kontraktues kompenson shpenzimet e bëra nga propozuesi për hartimin e dokumentacionit të propozimit të pakërkuar.

5. Kompensimi i përshkruar në pikën 4 të këtij neni jepet vetëm nëse propozuesi nuk është ofertues fitues.

6. Shuma e kompensimit për propozuesin përcaktohet nga autoriteti kontraktues, në përpjesëtim me vlerën e projektit dhe asnjëherë nuk duhet të jetë më e ulët se 0,5 për qind ose më e lartë se 2 për qind të vlerës së koncesionit/partneritetit publik privat.

7. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat për vlerësimin e pranueshmërisë, përmbajtjen dhe trajtimin e propozimeve të pakërkua, mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve të kompensimit, si dhe të gjitha çështjet e tjera përkatëse.

KREU IV

KONTRATA E KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

Neni 26

Lidhja e kontratës

1. Autoriteti kontraktues nuk mund të lidhë kontratën para skadimit të periudhës së pritjes së ankesave, e përcaktuar në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

2. Lidhja e kontratës para përfundimit të afatit të njoftimit të klasifikimit apo para se të ketë përfunduar shqyrtimi administrativ e bën atë absolutisht të pavlefshme.

3. Autoriteti kontraktues fton ofertuesin më të suksesshëm për lidhjen e kontratës jo më vonë se 10 ditë nga data e skadimit të periudhës së pritjes së ankesave, të përshkruar në pikën 1 të këtij neni.

4. Afati i vendosur në pikën 3 të këtij neni mund të zgjatet në raste të arsyetuara, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit.

5. Kontrata hartohet me shkrim dhe nënshkruhet nga personi i autorizuar i autoritetit kontraktues dhe ofertuesi i zgjedhur si më i suksesshmi.

6. Kur ofertuesi i përzgjedhur si më i suksesshmi, në përputhje me dokumentet e tenderit, me vendimin për dhënien e kontratës fituese dhe me ofertën e zgjedhur, është i detyruar të krijojë një subjekt për qëllime të veçanta (SPV), të rregulluar sipas legjislacionit në fuqi, si një shoqëri me seli në Republikën e Shqipërisë me shënimin para emrit “Shoqëri koncesionare” dhe me objekt “Objekti e kontratës së koncesionit”, autoriteti kontraktues nënshkruan kontratën me personin e autorizuar të shoqërisë në fjalë.

7. Autoriteti kontraktues, me përfundimin e regjistrimit, sipas legjislacionit në fuqi, të shoqërisë koncesionare, dërgon një kopje të kontratës dhe ekstraktit të regjistrimit në Ministrinë e Financave.

8. Nëse ofertuesi i zgjedhur si më i suksesshmi tërhiqet nga lidhja e kontratës ose nuk dorëzon në kohën e përcaktuar garancitë dhe instrumentet e përshkruara në nenin 28 të këtij ligji, atëherë autoriteti kontraktues mund të marrë një vendim të ri për dhënien e kontratës dhe t'i ofrojë nënshkrimin e kontratës ofertuesit të radhës që është renditur si më i miri.

Neni 27

Përmbajtja e kontratës

1. Kontrata përcakton të drejtat dhe detyrimet e autoritetit kontraktues dhe koncesionarit/partnerit privat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

2. Çështjet e kontratës, që nuk rregullohen me këtë ligj, janë subjekt i dispozitave të Kodit Civil.

3. Kontrata duhet të hartohet në përputhje me dokumentet e tenderit, me informacionet që gjenden në njoftimin e kontratës, me ofertën e zgjedhur dhe me njoftimin e dhënies së kontratës.

4. Përveç kontratës, autoriteti kontraktues ka të drejtën, në përputhje me këtë ligj, me dokumentet e tenderit, me vendimin e dhënies së koncesionit dhe me ofertën e zgjedhur, të lidhë marrëveshje dhe/ose kontrata shtesë dhe/ose të kushtëzuara, rast në të cilin autoriteti kontraktues njofton paraprakisht Ministrinë e Financave.

5. Marrëveshje dhe/ose kontrata shtesë dhe/ose të kushtëzuara, të përshkruara në pikën 4 të këtij neni, quhen në veçanti ato, të cilat janë të lidhura për të siguruar financimin e nevojshëm për zbatimin e kontratës.

6. Kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat rregullon, në përputhje me dokumentacionin e tenderit, me vendimin e dhënies së koncesionit dhe me ofertën e zgjedhur, të gjitha çështjet që janë të lidhura me pronësinë e pasurive të paluajtshme dhe pasurive të tjera, që janë objekt i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat dhe pronësinë e pasurive të paluajtshme ose jo, që lindin në bazë të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat për kohëzgjatjen e saj apo pas përfundimit të saj.

Neni 28

Garancitë e realizimit të kontratës

1. Para nënshkrimit ose hyrjes në fuqi të kontratës, autoriteti kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancitë e kërkuara për realizimin e kontratës dhe instrumentet e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet si pasojë e dështimit të koncesionarëve/partnerëve privatë për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë (premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale etj.), pasi këto janë të përcaktuara nga dokumentet e tenderit dhe/ose vendimin për zgjedhjen e ofertës më të suksesshme.

2. Garancitë dhe instrumentet e sigurisë depozitohen pranë autoritetit kontraktues, i cili është i detyruar t'i ruajë ato gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

3. Autoriteti kontraktues verifikon rregullisht vlefshmërinë e instrumenteve të sigurisë.

4. Në bazë të pikës 3 të këtij neni dhe në rast se instrumenti i mbyllur i sigurisë nuk është i vlefshëm, autoriteti kontraktues i kërkon pa vonesë koncesionarit/partnerit privat të paraqesë një instrument të ri të sigurisë.

Neni 29

Tarifa e koncesionit

1. Nëse është përcaktuar në studimin e fizibilitetit, koncesionari paguan një kompensim monetar për koncesionin në shumën dhe në mënyrën e përcaktuar në kontratën e koncesionit.

2. Tarifa koncesionare paguhet në përputhje me rregullat e caktuara nga Ministri i Financave për arkëtimin e të ardhurave për llogari të Buxhetit të Shtetit.

3. Shuma dhe afatet e pagesës së tarifës së koncesionit përcaktohen në përpjesëtim me objektin e koncesionit, me vlerën e parashikuar të kontratës së koncesionit, kohëzgjatjen e kontratës, risqet dhe kostot që koncesionari merr përsipër dhe fitimin e pritshëm, si dhe me nivelin e pajisjeve dhe vlerën e pronës së dhënë, sipas kontratës së koncesionit nga autoriteti kontraktues.

4. Kontrata e koncesionit mund të përcaktojë ndryshueshmërinë e shumës dhe/ose mënyrën e llogaritjes dhe të pagesës së tarifës së koncesionit brenda një periudhe kohore të caktuar, gjatë të gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit, në përputhje me dokumentacionin e tenderit dhe me vendimin për dhënien e kontratës.

5. Tarifat e koncesionit janë pjesë e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose të buxheteve të organeve të qeverisjes vendore.

Neni 30

Afati i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat

1. Kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat lidhet për një periudhë të caktuar.
2. Autoriteti kontraktues përcakton në studimin e fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat afatin e kontratës, në mënyrë të tillë që kohëzgjatja e saj nuk e kufizon konkurrencën më shumë sesa është e nevojshme, që të sigurohet amortizimi i vlerës reale të investimeve të koncesionarëve/partnerëve privatë dhe një normë e arsyeshme e kthimit të investimit, duke marrë parasysh kostot dhe risqet e marra përsipër nga koncesionari/partneri privat për kohëzgjatjen e kontratës.
3. Kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se 35 vjet.
4. Afati kohor, për të cilin është dhënë koncesioni/partneriteti publik privat, fillon nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.
5. Afati kohor i kontratës mund të zgjatet, nëse është e nevojshme, për shkak të ndryshimeve të kontratës, siç parashikohet në nenet 31, 32 dhe 33 të këtij ligji.

Neni 31

Ndryshimi i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat

1. Kontratat e parashikuara me këtë ligj mund të ndryshohen duke i shtuar kontratës një aneks, me kusht që kjo mundësi të parashikohet në dokumentacionin e tenderit dhe në kontratë.
2. Ndryshimet në kontratë bëhen nga autoriteti kontraktues dhe koncesionari/partneri privat.
3. Ndryshimet në kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktuese veçanërisht në rastet e mëposhtme:
 - a) kur rrezikohet siguria kombëtare dhe mbrojtja e vendit, rrezikohet mjedisi, natyra dhe shëndeti i njerëzve;
 - b) kur humbet objekti i kontratës ose kur ekziston një pamundësi objektive për përdorimin e tij, në rastin e forcës madhore;
 - c) gjatë ndryshimit të kuadrit ligjor;
 - ç) në raste të tjera që çojnë në ndryshimin e situatës reale ose ligjore për përdorimin e objektit apo ofrimin e shërbimeve ose në realizimin e kontratës.
4. Ndryshimet e kushteve thelbësore të kontratës, që nuk parashikohen në dokumentacionin e tenderit dhe/ose në vetë kontratën, kërkojnë zbatimin e një procedure të re të dhënies së kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.
5. Pa shkelur dispozitat e neneve 32 dhe 33 të këtij ligji, termi “kushtet thelbësore” u referohet në veçanti kushteve, të cilat, nëse do të kishin qenë të përfshira në njoftimin fillestar të kontratës ose në dokumentacionin e tenderit, do të kishin bërë të mundur që ofertuesit të dorëzonin një ofertë në thelb të ndryshme, si dhe nëse ndryshimet do të kishin tejkaluar objektin e kontratës në atë masë që këto ndryshime do të përfshinin shërbimet që nuk mbulohen fillimisht.
6. Autoriteti kontraktues kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave për të gjitha ndryshimet e planifikuara, të cilat ndikojnë ose krijojnë riskun e ndikimit direkt ose indirekt në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e organeve vendore, apo të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare, siç përcaktohet nga ky ligj.
7. Autoriteti kontraktues njofton, jo më vonë se 20 ditë, Ministrinë e Financave për ndryshimet e bëra në kontratë në përputhje me këtë nen.

Neni 32

Transferimi i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat

1. Në përputhje me dispozitat e këtij neni, me pëlqimin paraprak me shkrim nga autoriteti kontraktues, kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat mund të transferohet te një person i tretë, që përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, në bazë të të cilit kontrata ishte dhënë fillimisht, përveçse nëse këto kërkesa u referohen kushteve që nuk janë më të

nevojshme për përmbushjen e kontratës, për shkak të faktit se këto detyrime dhe kërkesa të përmendura janë tashmë duke u konsumuar ose duke u realizuar nga koncesionari/partneri privat i mëparshëm.

2. Transferimi i kontratës së koncesionit nuk prish cilësinë dhe nuk përkeqëson vazhdimësinë e realizimit dhe të përmbushjes së kontratës.

3. Kur koncesionari/partneri privat është një subjekt për qëllime të veçanta, atëherë ndryshimi i të drejtave të pronësisë apo i menaxhimit të subjektit për qëllime të veçanta (SPV), si rezultat i transferimit të kapitaleve ose të aksioneve të biznesit, nuk mund të zbatohet pa miratimin e autoritetit kontraktues dhe të Ministrisë së Financave, përveçse nëse ky është një rezultat i tregtimit të rregullt të aksioneve në një treg të rregulluar të kapitalit.

4. Autoriteti kontraktues kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave për të gjitha transferimet e planifikuara të kontratës, të cilat ndikojnë ose krijojnë rrezikun e ndikimit në ndonjë mënyrë në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, ose të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare, siç përcaktohet nga ky ligj.

5. Autoriteti kontraktues njofton Ministrinë e Financave për transferimet e kontratës, të bëra në përputhje me këtë nen.

Neni 33

Rregullat për dhënien e punëve dhe shërbimeve shtesë për koncesionarët/partnerët privatë

1. Autoriteti kontraktues mund t'i japë koncesionarit, pa kryer një procedurë të re për dhënien e koncesionit, punë dhe/ose shërbime shtesë, të cilat nuk janë të përfshira në kontratën bazë, por që, për shkak të rrethanave të paparashikuara, bëhen të nevojshme për kryerjen e punës apo shërbimit të përshkruar në atë kontratë, të cilat autoriteti kontraktues ia ka dhënë koncesionarit, me kusht që kontrata t'i jepet koncesionarit që kryen punë ose shërbim, që është objekt i kontratës kur:

a) vepra të tilla ose shërbimet shtesë nuk mund të ndahen teknikisht ose ekonomikisht nga kontrata bazë, pa i shkaktuar vështirësi të mëdha koncesionarit; ose

b) këto punime ose shërbime, edhe pse të ndashme nga realizimi i kontratës bazë, janë të domosdoshme për përfundimin e saj.

2. Vlera e kontratave të dhëna për punët ose shërbimet shtesë nuk mund të tejkalojë 30 për qind të vlerës së kontratës bazë të koncesionit.

3. Për dhënien e punëve ose të shërbimeve shtesë operatorëve ekonomikë, që veprojnë si partnerë privatë, në rastin e partneriteteve publike private të realizuara si kontrata të punëve apo të shërbimeve publike, dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik zbatohen në përputhje me rrethanat.

4. Autoriteti kontraktues njofton Ministrinë e Financave për çdo dhënie të punëve ose shërbimeve shtesë, të bëra në përputhje me këtë nen.

Neni 34

Nënkontraktimi

1. Autoriteti kontraktues mund:

a) t'i kërkojë koncesionarit që të japë kontrata që janë minimalisht 30 për qind e vlerës totale të kontratës së koncesionit të palët e treta, duke siguruar, në të njëjtën kohë, një mundësi për tenderuesit që ta rrisin këtë përqindje, ndërkohë që kjo përqindje minimale specifikohet në kontratën e koncesionit;

b) të kërkojë nga tenderuesit që të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e vlerës totale të kontratës që ata planifikojnë t'u caktojnë palëve të treta.

2. Për nënkontraktimin e partneriteteve publike private, që realizohen si kontrata të punëve publike ose të shërbimit publik, zbatohen dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik, në përputhje me rrethanat.

Neni 35

Rregullat në fuqi për kontratat e punëve që u jepen palëve të treta nga koncesionarët e punëve publike

1. Këto rregulla zbatohen për punët publike të koncesionarëve, të cilat, sipas këtij ligji, nuk janë autoritete kontraktuese.

2. Kur një koncesionar u jep kontrata punësh palëve të treta në një vlerë të përlogaritur mbi 700 000 000 lekë, duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar, koncesionari zbaton rregullat e mëposhtme:

a) koncesionari publikon në mënyrë të detyrueshme dhe në një formular standard njoftimin e kontratës në Buletinin e Prokurimit Publik, me synimin për dhënien e kontratës së punëve palëve të treta;

b) afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje përcaktohet nga koncesionari dhe nuk duhet të jetë më i shkurtër se 37 ditë nga data e publikimit të njoftimit të kontratës;

c) afati i fundit për dorëzimin e ofertave përcaktohet nga koncesionari dhe nuk duhet të jetë më i shkurtër se 40 ditë nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, domethënë nga dërgimi i ftesave për dorëzimin e ofertave;

ç) me përjashtim të përcaktimit të shkronjave “b” dhe “c” të kësaj pike, në rastin kur kërkesa për pjesëmarrje dhe ofertat janë paraqitur me anë të mjeteve elektronike, zbatohet ligji i prokurimit publik, në përputhje me rrethanat, edhe për shkurtimin e afateve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni;

d) afatet kohore për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe ofertave shtyhen në një mënyrë, në të cilën të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë mund të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm, në rastet e mëposhtme:

i) nëse dokumentacioni i tenderit dhe të gjitha informacionet shtesë nuk janë dhënë në afatet e parashikuara;

ii) nëse nuk sigurohet vizita dhe informacioni për vendin e ndërtimit dhe për të gjitha dokumentet e nevojshme për përgatitjen e ofertave.

3. Vlera e kontratave të përmendura në pikën 2 të këtij neni llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Grupet e shoqërive, të cilat janë formuar për të marrë koncesionin ose shoqëritë që lidhen me to nuk konsiderohen palë të treta.

5. “Shoqëri e lidhur” ka kuptimin e çdo shoqërie tjetër, që lidhet me koncesionarin nëpërmjet pronësisë, kontrollit dhe drejtimit të përbashkët. Mund të realizohet në një nga format e mëposhtme ku:

a) koncesionari mund të ushtrojë një ndikim mbizotërues, direkt apo indirekt, mbi shoqërinë;

b) shoqëria mund të ushtrojë një ndikim mbizotërues, direkt apo indirekt, mbi koncesionarin.

6. Ndikimi mbizotërues nga ana e shoqërisë presupozohet kur, direkt apo indirekt, në lidhje me një shoqëri tjetër, ajo:

a) mban shumicën e kapitalit të nënshkruar të shoqërisë;

b) kontrollon shumicën e votave bashkëngjitur aksioneve të emetuara nga shoqëria; ose

c) mund të emërojë më shumë se gjysmën e organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës të shoqërisë.

7. Lista shteruese e shoqërive të tilla përfshihet në kërkesën për koncesion. Koncesionari informon autoritetin kontraktues për çdo ndryshim të mëvonshëm në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive.

Neni 36

Zgjidhja e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, autoriteti kontraktues mund të ndërpresë kontratën kur:

a) mund të provojë se koncesionari/partneri privat nuk mund të kryejë detyrimet e veta, për shkak të paaftësisë pague, shkeljeve serioze apo çështjeve të tjera që pengojnë apo nuk lejojnë vazhdimin e kontratës, në përputhje me standardet teknike dhe me standardet e tjera të pranuara;

b) koncesionari/partneri privat dështon në sigurimin e financimit të projektit brenda 12 muajve nga nënshkrimi ose hyrja në fuqi e kontratës.

2. Secila palë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, ka të drejtë të zgjidhë

kontratën kur:

- a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave të secilës palë;
 - b) ka shkelje serioze nga pala tjetër dhe se kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
3. Palët kanë, gjithashtu, të drejtë të zgjidhin kontratën me pëlqimin reciprok.
4. Para zgjidhjes së kontratës, në përputhje me këtë nen, autoriteti kontraktues informon Ministrinë e Financave për të gjitha rrethanat e njohura, të cilat çojnë dhe krijojnë kushtet për zgjidhjen e kontratës dhe kërkon mendimin e saj.

KREU V ÇËSHTJET FINANCIARE DHE ÇËSHTJET E LIDHURA

Neni 37

Marrëdhëniet e pronësisë

1. Në rast se një kontratë koncesioni/partneriteti publik privat përfshin përdorimin e pasurisë në pronësi të një personi, që nuk është i përfshirë në procedurën për dhënie të kontratës, marrëdhëniet e pronësisë që shoqërojnë një pasuri të tillë duhet të zgjidhen sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar.
2. Nëse Republika e Shqipërisë është pronare e pasurisë së paluajtshme, të përfshirë në realizimin e një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat, ose nëse koncesioni/partneriteti publik privat përfshin përdorimin e të mirave publike, atëherë autoriteti kontraktues zgjidh të gjitha marrëdhëniet e pronësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në një mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar.

Neni 38

E drejta e pronësisë

1. Objektet e ndërtuara në bazë të një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat, duke përfshirë shtesat dhe përmirësimet, janë në pronësi të autoritetit kontraktues, përveçse kur parashikohet ndryshe në kontratë.
2. Në dokumentacionin e tenderit autoriteti kontraktues duhet të parashikojë kushtet, në bazë të të cilave rregullohen të drejtat e pronësisë, të përshkruara në pikën 1 të këtij neni.
3. Pas zgjidhjes së kontratës, koncesionari/partneri privat është i detyruar të dorëzojë objektet e ndërtuara në bazë të kontratës, pavarësisht nëse ato janë ndërtuar, rindërtuar, ruajtur, pajisur ose përmirësuar, tërësisht ose pjesërisht, sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar në kontratë, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.
4. Të gjitha çështjet, duke përfshirë edhe kushtet që kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë, si dhe standardet e kërkuara të cilësisë, janë objekt i analizës së studimit të fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat për atë kontratë dhe të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, si dhe në vetë kontratën.

Neni 39

Subjekti për qëllime të veçanta (SPV)

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë në dokumentacionin e tenderit që operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm të krijojë një person juridik, me seli në Republikën e Shqipërisë, i cili lidh kontratën.
2. Subjekti për qëllime të veçanta mund të marrë pjesë vetëm në realizimin e një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat, për të cilën ai është themeluar.
3. Në rastin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, në dokumentacionin e tenderit përcaktohen forma e personit juridik, shuma minimale e kapitalit, detyrimet e ofertuesit më të suksesshëm, në lidhje me themelimin e saj, si dhe marrëdhëniet e tjera midis ofertuesit më të suksesshëm, subjektit për qëllime të veçanta dhe autoritetit kontraktues.

Neni 40
Interesat e sigurisë

1. Koncesionari/partneri privat mund sigurojë të drejtat e tij ndaj çdo pagese të çdo lloji të marrë ose që pritët të merret nga ai në zbatim të një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat ose në lidhje me të, pa cenuar të drejtën e tij ndaj çdo pjese tjetër të pasurisë së tij. Ky sigurim nuk mund të krijohet pa pëlqimin e autoritetit kontraktues dhe mund të bëhet vetëm në favor të institucioneve financiare për të siguruar pretendimet e këtyre institucioneve, mbi bazën e kontratës së kredisë.

2. Pretendimet e institucionit financiar, sipas pikës 1 të këtij neni, lidhen vetëm me instrumentet financiare të fituara për qëllime të ekzekutimit të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat dhe nuk përfshijnë asnjë nga pretendimet e tjera që institucionet financiare kanë ndaj koncesionarit/partnerit privat për arsye të tjera.

Neni 41
Dispozita e stabilizimit

1. Autoriteti kontraktues mund të hyjë në një angazhim detyrues, në emër të shtetit, që do të ketë efektin e sigurimit të garancive të përshtatshme në favor të koncesionarit/partnerit privat, me të cilin do të mbrohet kundër pasojave financiare të legjislacionit, i cili hyn në fuqi pas fillimit të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, që u nënshtrohet kufizimeve të mëposhtme:

- a) pasojat financiare duhet të përshkruhen në mënyrë të qartë dhe të saktë;
- b) angazhimi përfundon me përfundimin e marrëveshjes së koncesionit;
- c) duhet të përshkruhet natyra e legjislacionit.

2. Një angazhim i tillë detyrues miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me kërkesën e autoritetit kontraktues.

Neni 42
Mbështetja financiare

1. Projekti që ka nevojë për mbështetje financiare, siç përcaktohet nga studimi i fizibilitetit, kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave, në lidhje me përballueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal, domethënë ndikimet dhe risqet fiskale të menjëhershme dhe urgjente.

2. Për qëllime të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, autoriteti kontraktues duhet të dorëzojë studimin e fizibilitetit të objektit dhe projekt-kontratën pranë Ministrisë së Financave.

3. Këshilli i Ministrave miraton një rregullore për mënyrën e sjelljes dhe kriteret e miratimit të projektit të përshkruar në pikën 1 të këtij neni.

KREU VI
SHQYRTIMI ADMINISTRATIV

Neni 43
Procedura administrative dhe hetimi administrativ

Dispozitat e ligjit të prokurimit publik, që rregullojnë procedurat administrative të shqyrtimit dhe procedurat e hetimit administrativ, zbatohen në përputhje me rrethanat për dhënien e të gjitha kontratave të koncesionit dhe të partneritetit publik privat, të parashikuara me këtë ligj.

Neni 44
Detyrimi për bashkëpunim

Refuzimi i nëpunësit civil, i funksionarit ose autoritetit kontraktues për të dhënë informacion apo për të paraqitur dokumentacionin që ka lidhje me procedurën nën hetim administrativ, përbën shkak që Komisioni i Prokurimit Publik, Ministria e Financave ose Agjencia e Prokurimit Publik të kërkojnë marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Neni 45
Kundërvajtjet administrative

1. Shkelja e dispozitave të këtij ligji nga personat përgjegjës, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 1 000 000 lekë. Gjoba vendoset nga Agjencia e Prokurimit Publik.

2. Ministri i Financave, Agjencia e Prokurimit Publik ose Komisioni i Prokurimit Publik, kur është rasti, mund t'i propozojnë drejtuesit të autoritetit kontraktues marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Neni 46
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat rregullohet nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.

2. Koncesionari/partneri privat, aksionarët e tij dhe ortakët e tjerë të biznesit janë të lirë të zgjedhin ligjin që rregullon marrëdhëniet e ndërsjella të tyre të biznesit.

3. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit/ partnerit privat zgjidhet përmes mekanizmave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të pranuar nga palët në kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat, duke përfshirë edhe procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar.

4. Koncesionari/partneri privat, aksionarët e tij dhe ortakët e tjerë të biznesit janë të lirë të zgjedhin mekanizmat e duhur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

KREU VII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 47
Shfuqizimet

Ligji nr. 9663, datë 18.12. 2006 “Për koncesionet”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 48
Zbatimi i dispozitave

Dispozitat e ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, zbatohen për procedurat e dhënies së kontratave të koncesionit dhe për procedurat e shqyrtimit të filluara, si dhe kontratat e lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 49
Rregulloret për zbatimin e ligjit

Këshilli i Ministrave, brenda një afati prej tre muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktet nënligjore në zbatim të pikave 2 dhe 3 të nenit 4, të pikës 2 të nenit 5, të pikës 2 të nenit 7, të pikës 3 të

nenit 8, të pikës 3 të nenit 14, të pikës 5 të nenit 16, të pikës 2 të nenit 21, të pikës 5 të nenit 24, të pikës 7 të nenit 25, të pikës 3 të nenit 42, si dhe aktet e tjera nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

Neni 50

Kontratat e koncesionit të nënshkruara

Ky ligj nuk zbatohet për kontratat e koncesionit të nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave që rregullojnë regjistrin e koncesioneve/partneriteteve publike private, të cilat duhet të rregullohen brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 51

Zbatimi i përjashtimit për koncesionet e HEC-ve

Shkronja “i” e pikës 1 të nenit 5 dhe neni 7 shfuqizohen pas 4 viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 52

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.4.2013

Shpallur me dekretin nr. 8149, datë 2.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani